

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6356  
E martë, 6 korrik 2021  
çmimi 0.40 €

### Krasniqi në takim me shqiptaro-amerikanët Marrëdhëniet me ShBA-në janë të shenjta dhe të përhershme



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



FLET PËR "EPOKËN E RE", BELUL BEQAJ | FAQE 4-5

## QEVERIA TË SILLET NË PËRPUTHJE ME KËRKESAT E ADMINISTRATËS BIDEN



Politologu Belul Beqaj ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet të silltet në përputhje të kërkesave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka paralajmëruar se mosrespektimi i kërkesave amerikane mund ta fusë

Kosovën në aventurë me pasoja të paparashikueshme. Beqaj ka deklaruar se nuk pret që Kosova dhe Serbia të arrijnë ndonjë marrëveshje të shpejtë në procesin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve të ndërmjetësuar nga BE-ja

### AKTUALE




**PRESIDENTI I MALIT TË ZI: BE-ja TA MIRATOJË LIBERALIZIMIN E VIZAVE PËR KOSOVËN** F. 3

**PUBLIKOHEN REZULTATET E TESTIT TË MATURËS, KALUESHMËRIA MBI 68 PËR QIND** F. 6

**FAMILJARËT E TË PAGJETURVE KËRKOJNË TË PËRFSHIHEN NË DIALOGUN ME SERBINË** F. 7

**DY OFICERË TË FSK-së DIPLOMOJNË NË KOLEGJIN E USHTRISË AMERIKANE** F. 6

### EKONOMI



**SENATORJA AMERIKANE: KA MËNYRA KONKRETE PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS** F. 9

**PAKOJA E RINGJALLJES EKONOMIKE, 50 MILIONË EURO PLANIFIKOHEN TË NDAHEN PËR PUNËSIM** F. 9

**BQK-ja: EKONOMIA E KOSOVËS NË VITIN 2020 SHËNOI RËNIE PËR 3.9 PËR QIND** F. 9

**10 VJET BURGIM PËR SERBIN QË DHUNOI SEKSUALISHT NJË SHQIPTARE GJATË LUFTËS NË KOSOVË**



**KRYEMINISTRI IZRAELIT I SHKRUAN KURTIT: IZRAELI DO T'JU NDIHMOJË PËR RUAJTJEN E MONUMENTEVE ME VLERË UNIVERSALE KULTURORE** | FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 870 | 045 500 870  
044 500 870 | 049 500 870

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Ministrja Gjonaj flet për të arriturat e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit

TIRANË, 5 KORRIK (ER) - Ministrja e Drejtësisë e Shqipërisë, Etilda Gjonaj, ka marrë pjesë në konferencën mbi sfidat dhe mundësitë në luftën kundër korrupsionit dhe forcimin e integritetit. Në këtë konferencë ka marrë pjesë edhe kryeprokurori i Rumanisë, i cili ka ndarë përvojën që ka kaluar ky shtet në luftën kundër korrupsionit. Po në këtë konferencë ka marrë pjesë edhe ambasadori i BE-së në Tiranë, Luigi Soreca dhe sekretarja ekzekutive e GRECO-s, Hane Juncher, e cila ka theksuar domosdoshmërinë e forcimit të bashkëpunimit rajonal kundër korrupsionit, përmirësimin e masave të konfiskimit të



pasurive dhe rikuperimit të aseteve. Në këtë konferencë ministrja Gjonaj ka renditur arritjet e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit. Gjonaj ka thënë se

strukturat e reja të posaçme me luftën ndaj korrupsionit dhe pandëshkueshmërisë kanë filluar të flasin në emër të drejtësisë penale të re me raste konkrete të procedimeve penale

të nisura dhe përfunduara, me pasuri të sekuestruara brenda dhe jashtë sistemit. "Pas pesë vjetësh nga miratimi i reformës në drejtësi, dëshmohet qartë se vullneti ka qenë i palëkundur, se nuk jemi stepur në asnjë çast për ta çuar përpara me hapa solide procesin më transformues në Shqipëri në 30 vjetëve të fundit, kjo nga ne si mazhorancë, si qeveri, por edhe nga vetë partnerët ndërkombëtarë ShBA dhe BE, të cilët në asnjë çast nuk kanë reshtur së dhëni mbështetje zbatimit të reformës në drejtësi. Njëpërmjet vetting-ut po pastrohet rrënjësisht sistemi i drejtësisë nga elementët e korruptuar, joprofesionale apo me lidhje të dyshimta me krimin.

Nga rreth 50 për qind të gjyqtarëve dhe prokurorëve të vetuar, më shumë se 60 për qind janë larguar nga sistemi. Strukturat e reja të posaçme me luftën ndaj korrupsionit dhe pandëshkueshmërisë kanë filluar të flasin në emër të drejtësisë penale të re me raste konkrete të procedimeve penale të nisura dhe përfunduara, me pasuri të sekuestruara brenda dhe jashtë sistemit. Jam besimplotë se SPAK-u bashkë me BKH-në që sapo ka emëruar 28 hetuesit e parë, do të mund të bëjnë raste suksesi që lidhen me luftën kundër pandëshkueshmërisë për veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar", ka deklaruar Gjonaj.

## Kryeministri i Hungarisë futet në listën e 'armiqve të lirisë së shtypit'

BUDAPEST, 5 KORRIK - Organizata e Reporterëve pa Kufij e ka përfshirë kryeministrin e Hungarisë, Viktor Orban, në listën e saj vjetore të "armiqve të lirisë së shtypit". Është hera e parë që kryetari i një qeverie të Bashkimit Evropian shfaqet në këtë listë së bashku me udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jong-un, presidentin e Sirisë, Bashar Al-Assad etj. Vëzhguesi i mediave ka thënë se Orban dhe partia e tij Fidesz "e kanë sjellë peizazhin mediatic të Hungarisë, hap pas hapi, nën kontrollin e tyre", qëkur kanë marrë pushtetin në vitin 2010.

Organizata e Reporterëve pa Kufij ka theksuar se Orban i ka shënjestruar mediat me mjete të tilla si "mashtimet politiko-ekonomike, diskreditimi dhe vetëcensura". Sipas Reporterëve pa Kufij, shtypi rajonal i Hungarisë ka qenë plotësisht në pronësi të sipërmarrësve që janë miq me Orbanin, që nga vera e vitit 2017. "Në vjeshtën e vitit 2018 gati 500 kompani mediatike proqeveritare janë bashkuar në një kompani për ta koordinuar mbulimin e tyre", kanë thënë Reporterët pa Kufij. Në Indeksin e Lirisë së Shtypit,

të përpiluar nga Reporterët pa Kufij këtë vit, Hungaria është renditur e 92-ta në mesin e 180 vendeve. Lista e "armiqve të lirisë së shtypit" përfshin 37 udhëheqës të shteteve dhe qeverive që shtypin lirinë e mediave. Lista përfshin udhëheqësin suprem të Iranit, Ajatollah Ali Khamenei, presidentin rus Vladimir Putin, Alyaksandr Lukashenkën e Bjellorusisë, Ramzan Kadyrovin e Çeçenisë, Emomali Rahmonin e Tashkistanit dhe Gurbanguly Berdimukhammedovin e Turkmenistanit.



## Indonezia përballet me mungesë të oksigjenit



XHAKARTA, 5 KORRIK - Qeveria e Indonezisë i ka urdhëruar prodhuesit që t'i japin përparësi oksigjenit mjekësor në kohën kur ky vend po përballet me rritje të numrit të rasteve me koronavirus dhe mungesë të oksigjenit në disa qytete. Një spital raportoi për vdekjen e 63 pacientëve për shkak të mungesës së oksigjenit, shkruan "BBC". Indonezia është duke regjistruar më shumë se 25 000 raste të reja

me koronavirus çdo ditë. Udhëtimet në rritje dhe varianti shumë ngjitës "Delta" i koronavirusit e kanë përkeqësuar krizën. Indonezia është vendi më i prekur në Azinë Juglindore, me rreth 2.3 milionë raste të regjistruara pozitive dhe mbi 60 000 viktima. Ekspertët kanë paralajmëruar se numrat e përgjithshëm mund të jenë shumë më të lartë për shkak të testeve joadekuate jashtë kryeqytetit Xhakarta.

Javën e kaluar autoritetet kanë futur në izolim ishullin kryesor Java dhe ishullin turistik Bali. Zyrtarja e Ministrisë së Shëndetësisë në Indonezi, Siti Nadia Tarmizi, ka thënë se i ka kërkuar industrisë së gazit ta rrisë prodhimin e oksigjenit mjekësor dhe u bëri thirrje njerëzve që të mos grumbullojnë rezerva. Ka pasur raporte se njerëzit po përpiqen të sigurojnë privatisht bombola oksigjeni për t'i trajtuar pacientët në shtëpi.

## Papa i nënshtrohet një operacioni

VATIKAN, 5 KORRIK - Papa Françesku i është nënshtrohuar një operacioni në zorrën e trashë, ka bërë me dije Vatikani. Zëdhënësi Matteo Bruni ka thënë se Papa, 84 vjeç, "i është përgjigjur mirë" trajtimit, që

është bërë në një spital të Romës. Kjo është hera e parë që Papa pranohet në spital prejse është zgjedhur në krye të Selisë së Shenjtë në vitin 2013. Vatikani nuk dha detaje të tjera për

operacionin apo për kohën sa do të qëndrojë Papa në spital. Gjatë një fjalimi të dielën në sheshin "Shën Pjetri", Papa ka njoftuar se do t'i vizitojë Hungarinë dhe Sllovinë në shtator. I lindur në vitin 1936 në Buenos Aires,

Françesku ka humbur një pjesë të mushkërive në moshën 21-vjeçare. Ai, gjithashtu, vuan nga një problem në ijë. Në vitin 2014 atij i është dashur të anulohet një numër angazhimesh për shkak të një sëmundjeje të stomakut.



## Kryeministri izraelit i shkruan Kurtit: Izraeli do t'ju ndihmojë në ruajtjen e monumenteve me vlerë universale kulturore

PRISHTINË, 4 KORRIK - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka pranuar nga kryeministri i Izraelit, Naftali Bennett, përgjigje në letrën që ia pati dërguar atij dhe kryeministrave e presidentëve të 56 vendeve të botës. Në letër, kryeministri Kurti ka shprehur pikëpamjet e Republikës së Kosovës mbi trashëgiminë kulturore dhe rëndësinë e mbrojtjes së saj.

Duke e falënderuar për letrën, kryeministri Bennett është shprehur mirënjohës që kryeministri Kurti ka ndarë pikëpamjet e tij me të dhe me liderët e tjerë botërorë lidhur me temën e rëndësishme dhe delikate të mbrojtjes së

trashëgimisë kulturore.

"Izraeli me kënaqësi do t'ju ndihmojë në ruajtjen e monumenteve me vlerë universale kulturore, si dhe do t'ju ndihmojë në përkushtimin e vëmendjes për to, si dhe për shndërrimin e tyre në një destinacion turistik. Ne kemi një përvojë të madhe me objektet tona kulturore në Izrael, e sidomos në Jerusalem, dhe atë që ne e dimë në këtë aspekt, me kënaqësi do ta ndajmë me ju", është thënë në letrën e kryeministrit izraelit.

Në emër të Qeverisë së Izraelit, kryeministri Bennett ka shprehur falënderime për hapjen e Ambasadës së Kosovës në Jerusalem.



## Krasniqi në takim me shqiptaro-amerikanët: Marrëdhëniet me ShBA-në janë të shenjta dhe të përhershme

PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka nisur takimin e parë zyrtar me udhëheqësit e Kongresit Pan-Shqiptar Amerikan, Bruno Ceka dhe Martin Vulaj.

I shoqëruar nga Vlora Çitaku, e cila është rikthyer në PDK pas përfundimit të misionit diplomatik si ambasadore në ShBA, lideri i opozitës, Memli Krasniqi, ka diskutuar me shqiptaro-amerikanët për vizionin e tij për ta rritur bashkëpunimin me diasporën dhe për t'u dhënë atyre hapësirë e nevojshme në të gjitha nivelet e jetës politike e ekonomike në Kosovë.

"Ishte nder i veçantë që në takimin e parë si kryetar i PDK-së t'i kem mysafirë dy veprimtarë të shquar të çështjes kombëtare, udhëheqësit e



Kongresit Pan-Shqiptar Amerikan, Bruno Ceka dhe Martin Vulaj, të cilët, bashkë me shumë veprimtarë të tjerë, kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin kontribut të pazëvendësueshëm

për Kosovën", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook".

Krasniqi ka thënë se marrëdhëniet me ShBA-në janë të shenjta dhe të përhershme.

"Marrëdhëniet tona me Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të shenjta dhe duhet të jenë të përhershme. Për krijimin dhe mbajtjen e këtyre raporteve speciale me ShBA-në dhe aleatët tanë perëndimorë, merita të veçanta ka mërgata jonë. Si kryetar i PDK-së do të ruaj dhe zhvilloj më tej marrëdhëniet e bashkëpunimit me të gjitha organizatat e diasporës sonë dhe do të punoj për fuqizimin e rolit të diasporës në vendet ku jetojnë, duke krijuar edhe hapësirë e nevojshme për ta në të gjitha nivelet e jetës politike e ekonomike në Kosovë", ka shkruar Krasniqi.


## Presidenti i Malit të Zi: BE-ja ta miratojë liberalizimin e vizave për Kosovën

PODGORICË, 5 KORRIK - Presidenti i Malit të Zi, Milo Gjukanoviç, ka thënë se Bashkimi Evropian (BE) duhet ta miratojë liberalizimin e vizave për Kosovën dhe t'i japë shtytje procesit të negociatave me Malin e Zi dhe Serbinë. Në një intervistë për "TV21" të Shkupit, Gjukanoviç ka thënë se ai është i mendimit se BE-ja duhet t'i fillojë negociatat me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë sa më shpejt të jetë e

mundur. "Liberalizimi i vizave duhet t'i jepet Kosovës dhe një shtysë shtesë në procesin e negociatave me Malin e Zi dhe Serbinë", ka thënë Gjukanoviç. Më tutje, ai ka vënë re se vonesa në zgjerimin e Bashkimit Evropian, kur ishte radha e Ballkanit Perëndimor, lë hapësirë për ndikimin e palëve të treta. "Për fat të keq, ato palë të treta po veprojnë nga platforma që janë kundër interesave

thelbësore evropiane dhe kjo sjell konfuzion shtesë në politikën e vendeve të Ballkanit Perëndimor", ka thënë Gjukanoviç. Sipas tij, tani jemi dëshmitarë të ideve të rinovuara në lidhje me rikompozimin e Ballkanit Perëndimor. Ai ka theksuar se këto ishin idetë nga fillimi i viteve 1990, kur idetë e formimit të tri shteteve të mëdha të Ballkanit Perëndimor funksiononin ende.





FLET PËR "EPOKËN E RE", BELUL BEQAJ

## Qeveria të sillet në përputhje të kërkesave të administratës Biden

Politologu Belul Beqaj ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet të sillet në përputhje të kërkesave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka paralajmëruar se mosrespektimi i kërkesave amerikane mund ta fusë Kosovën në aventurë me pasoja të paparashikueshme. Beqaj ka deklaruar se nuk pret që Kosova dhe Serbia të arrijnë ndonjë marrëveshje të shpejtë në procesin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve të ndërmjetësuar nga BE-ja

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 5 KORRIK** - Politologu Belul Beqaj ka ftuar Qeverinë e Kosovës t'i respektojë kërkesat e administratës amerikane. Ai ka bërë me dije se çdo alternativë tjetër mund të ketë pasoja të mëdha për Republikën e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka shprehur skepticizëm për suksesin e dialogut Kosovë - Serbi. "Qeveria duhet të sillet konform kërkesave të administratës Biden. Çdo alternativë tjetër mund ta fusë Kosovën në aventurë me pasoja

të paparashikueshme", ka thënë Beqaj. Ai ka deklaruar se nuk pret që Kosova dhe Serbia të arrijnë ndonjë marrëveshje të shpejtë në procesin e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja. "Jo, nuk pres, por më duket se nuk është racionale të mbetemi në defansivë diplomatike për shkak të ambicieve joreale. Nuk mund të diskutojmë për statusin e marrëdhënieve pa e njohur Serbia statusin e shtetit të pavarur të Kosovës, apo jo!", është shprehur ai.

Beqaj ka vlerësuar se veprimet e deritanishme janë hap prapa zgjidhjes së dialogut me Serbinë. "Në fakt, deklarimet

publike të deritanishme vetëm sa po e ushqejnë politikën serbe që po e përdor dialogun për konsum të brendshëm në Serbi dhe për ta vazhduar mbështetjen ndërkombëtare regjimi i Aleksandër Vuçiqit! Pra, mungon qasja realiste që do ta implementonte marrëveshjen për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe si obligim i trashëguar, duke i përfillur vërejtjet e Gjykatës Kushtetuese, ngaqë alternativat janë më të këqija: status quo-ja, rikthim në këmbime territoriale dhe kthim të strukturave paralele që nënkupton konfliktin potencial", ka thënë ai.

Në këtë intervistë, Beqaj ka folur edhe për 100-ditëshin e parë të qeverisë Kurti. Ai ka thënë se gjatë kësaj periudhe qeveria ka marrë disa iniciativa të cilat mund të bëhen vendime inkurajuese. "Nismat për vetting, Ligji për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, Ligji për sigurime shëndetësore, demonopolizimi i homologimit, kontraktimi i vaksinave, shkarkimi i bordeve, janë indikacione të cilat mund të bëhen vendime inkurajuese nëse përfillet performanca dhe nëse përzgjedhja e kuadrove të reja bëhet duke respektuar ligjin, konkursin, konkurrencën dhe meritokracinë", ka deklaruar Beqaj.

**"Epoka e re":** Z. Beqaj, qeveria Kurti ka mbushur 100 ditë të punës. Cili është vlerësimi juaj për këtë periudhë të qeverisjes?  
**Beqaj:** Qeveria Kurti ka trashëguar probleme dhe pengesa të shtresuara ndër vite

të cilat nuk mund t'i zgjidhë gjatë një mandati, ndërsa zgjidhja e tyre brenda 100 dite është e pamundur edhe sikur të kishte shkop magjik! Por nismat për vetting, Ligji për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, Ligji për sigurime shëndetësore, demonopolizimi i homologimit, kontraktimi i vaksinave, shkarkimi i bordeve, janë indikacione të cilat mund të bëhen vendime inkurajuese nëse përfillet performanca dhe nëse përzgjedhja e kuadrove të reja bëhet duke respektuar ligjin, konkursin, konkurrencën dhe meritokracinë!

**"Epoka e re":** Në bazë të asaj që është parë deri më tani, besoni se kjo qeveri do të mund t'u përmbahet premtimeve që ka bërë?

**Beqaj:** Nuk e vlerësoj këtë qeveri se sa do t'u përmbahet premtimeve. Pavarësisht se situata nuk po ndryshon



shumë, politikëbërësit po. Kjo qeveri mund të ketë parim edhe ndërrimin e parimeve për shkak të kontekstit të ri të rrethanave të brendshme dhe ndërkombëtare, por ajo do të vlerësohet në sajë të rezultateve që presin qytetarët. Por nëse i ndërron parimet dhe nuk sjell rezultate, atëherë ajo duhet të analizojë veten se në cilin drejtim po shkon dhe çfarë epilogu do të ketë.

**“Epoka e re”:** Krahas pandemisë, një nga sfidat kryesore me të cilat po përballet kjo qeveri është edhe dialogu me Serbinë. Si e keni parë qasjen e kryeministrit Kurti në raport me dialogun e Brukselit?

**Beqaj:** Veprimet e deritanishme janë hap prapa zgjidhjes së dialogut me Serbinë. Në fakt, deklaratimet publike të deritanishme vetëm sa po e ushqejnë politikën serbe që po e përdor dialogun për konsum të brendshëm në Serbi dhe për ta vazhduar mbështetjen ndërkombëtare regjimi i Aleksandër Vuçiqit! Pra, mungon qasja realiste që do ta implementonte marrëveshjen për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe si obligim i trashëguar, duke i përfillur vërejtjet e Gjykatës Kushtetuese, ngaqë alternativat janë më të këqija: status quo-ja, rikthim në këmbime


territoriale dhe kthim të strukturave paralele që nënkupton konfliktin potencial!

**“Epoka e re”:** Takimi i dytë në mes të kryeministrit Kurti dhe presidentit Vuçiq pritet të mbahet në fund të këtij muaji. Nga qëndrimet e të dy udhëheqjeve mund të pritët ndonjë marrëveshje e shpejtë në mes të dy vendeve?

**Beqaj:** Jo, nuk pres, por më duket se nuk është racionale të mbetemi në defansivë diplomatike për shkak të ambicieve joreale. Nuk mund të diskutojmë për statusin e marrëdhënies pa e njohur Serbia statusin e shtetit të pavarur të Kosovës, apo jo?!

**“Epoka e re”:** Shtetet e Bashkuara ia kanë dorëzuar Qeverisë së Kosovës studimin e

fizibilitetit për liqenin e Ujmanit, ndërsa qeveria ende është duke e analizuar këtë dokument. Si duhet të sillët qeveria në raport me këtë dokument dhe marrëveshjen e Uashingtonit në përgjithësi? **Beqaj:** Qeveria duhet të sillët konform kërkesave të administratës Biden. Çdo alternativë tjetër mund ta fusë Kosovën në aventurë me pasoja të paparashikueshme!



## 10 vjet burgim për serbin që dhunoi seksualisht një shqiptare gjatë luftës në Kosovë

**PRISHTINË, 5 KORRIK (ER)** - Gjykata Themelore në Prishtinë ka dënuar me dhjetë vjet burgim ish-rezervistin e policisë serbe, Zoran Vukotiq, për kryerjen e veprës penale të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Ky është rasti i parë që dikush dënohet për një krim të tillë nga gjykatat e Kosovës.

Prokuroria Speciale e Kosovës kishte ngritur aktakuzë kundër Vukotiqit në mars të vitit 2020. Sipas njoftimit të prokurorisë, Vukotiqi “më 22 maj 1999, në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të forcave ushtarake, policore dhe paramilitare serbe, në territorin e komunës së Vushtrrisë ka marrë pjesë në dëbimin e popullatës civile shqiptare, kryerjen e dhunës fizike dhe psikike ndaj tyre si dhe, me përdorimin e dhunës dhe veprimeve të tjera çnjerëzore, ka kryer dhunim seksual si pjesë e një sulmi të gjerë dhe sistematik ndaj gruas së nacionalitetit shqiptar”.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka mirëpritur dënimin e ish-policit serb, Zoran Vukotiq,



për krime lufte në Kosovë. Megjithatë, në llogarinë e saj në “Twitter”, ajo ka shkruar se drejtësia e vonuar është e drejtësisë e mohuar. “Por mos të harrojmë se drejtësia e vonuar është e drejtësi e mohuar. Ne kemi nevojë për përgjegjësi dhe drejtësi për mijëra raste të tjera të grave të Kosovës”, ka shkruar Osmani.

Kurse ministrja e Drejtësisë,

Albulena Haxhiu, dënimin e Vukotiqit e ka cilësuar “lajm të mirë për të gjitha viktimat e dhunës seksuale të luftës, për qytetarët, por edhe për historinë dhe të ardhmen e Kosovës”. “Drejtësia për krimet e luftës do të bëhet dhe për këtë do të angazhohemi çdo ditë”, ka thënë Haxhiu.

Edhe Këshilli për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive të Njeriut

(KMDLNj) ka mirëpritur vendimin për dënimin e ish-policit serb Zoran Vukotiq.

Ky këshill ka vlerësuar se ky vendim është një hap drejt realizimit të së drejtës për drejtësi për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë. KMDLNj-ja në Prishtinë, dënimin e Vukotiqit e konsideron hap drejt realizimit të së drejtës për drejtësi për

viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë, si e drejtë e njeriut dhe shpagim moral për dëmet e pakompensueshme që u janë bërë këtyre viktimave. Dhunimi seksual, përveç si krim lufte në Kosovë, ka pasur edhe karakter etnik. Për KMDLNj-në ky dënim ngjallë shpresat se krimet e tilla nuk do të mbesin të pandëshkuara pavarësisht se deri më tani numri i të dënuarve është më se simbolik”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Në anën tjetër, sipas Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), dënimi i Vukotiqit shënon “një moment kthese dhe shprese” jo vetëm për viktimën që ka dëshmuar kundër Vukotiqit, por edhe për të mbijetuarit e tjerë “që një ditë drejtësia do të vihet në vend”. Sipas të dhënave të paraqitura nga institucionet në Kosovë, gjatë luftës së fundit janë rreth 20 mijë raste të dhunimeve seksuale nga pjesëtarë të forcave serbe.

## Dy oficerë të FSK-së diplomojnë në kolegjin e ushtrisë amerikane



PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Dy oficerë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) kanë diplomuar me sukses të lartë në Kolegjin e Shtabit dhe Komandës të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). Ministria e Mbrojtjes ka njoftuar se oficerët e FSK-së, major Vegim Krelani dhe major Jaser Mulla, kanë diplomuar në këtë kolegji. "Edhe pse ky vit ishte sfidues, pasi shumica e shkollimit u karakterizua nga mësimi virtual dhe mësimi në distancë, diplomimi me sukses i tyre nënkupton njohuri dhe profesionalizëm shtesë për të ardhmen e FSK-së", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Sipas njoftimit, nënkoloneli Christopher Mackin, shef i

edukimit në detaçmentin e 7-të të Kolegjit të vendosur në Evropë, ka vlerësuar lart të dy oficerët e FSK-së.

"Pjesëmarrja e Kosovës në degën evropiane të Kolegjit të Shtabit dhe Komandës së ShBA-së, bazuar në Grafenwoeher, Gjermani, është historike. Oficerët e saj ishin pjesë e grupit të parë ndërkombëtar prej katër studentëve të huaj që morën pjesë në këtë shkollim në Evropë. Ushtria amerikane për Evropë dhe Afrikë mirëpret pjesëmarrjen e ardhshme të kosovarëve në këtë shkollë. Ata mund ta falënderojnë majorin Mulla dhe majorin Krelani pasi kanë caktuar një standard të lartë të përsosmërisë akademike dhe të pjesëmarrjes së fuqishme aktive në klasë", ka thënë ai.

Kolegji i Shtabit dhe Komandës i Ushtrisë së ShBA-së është kolegji ushtarak post-diplomik njëvjeçar dhe shkollon oficerë ushtarakë amerikanë dhe të huaj. Ky shkollim në aspektin e edukimit profesional ushtarak konsiderohet si i domosdoshëm për oficerët e nivelit të mesëm për zhvillim të mëtutjeshëm në karrierë.

Fokusi i shkollimit është në udhëheqje, histori ushtarake, planifikim ushtarak, procese të vendimmarrjes, ndërsa rëndësi e veçantë i jepet mendimit kritik. Po ashtu, djali i ish-luftëtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Nezir Ismajli, Valdrini nga Prekazi, ka diplomuar në fushën e inteligjencës ushtarake, e cila është pjesë e Akademisë së ushtrisë së ShBA-së.

## Nënkolonel Besim Gashi përfaqëson Kosovën si atashe i mbrojtjes në Gjermani

BERLIN, 5 KORRIK (ER) - Nënkolonel Besim Gashi do ta përfaqësojë Kosovën si atashe i mbrojtjes në Republikën Federale të Gjermanisë. Lajmin e ka bërë me dije ambasadori në detyrë i Kosovës në Gjermani, Beqë Cufaj. Me këtë rast, Cufaj i ka uruar suksese Gashit për detyrën e re. "Ambasadës së Republikës së Kosovës në Berlin sot i është shtuar një koleg i ri. Nënkolonel Besim Gashi, atasheu i mbrojtjes i Republikës së Kosovës, do ta përfaqësojë

vendin tonë si atashe i mbrojtjes në Republikën Federale të Gjermanisë. Kosova është krenare me të kaluarën e saj dhe vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) nga e cila kanë dalë kadro që janë shkolluar dhe profesionalizuar në akademitë më të forta të shteteve aleate. Nënkolonel Besim Gashi i dëshirova mirëseardhje dhe sukses në misionin e tij të ri në një shtet kaq të rëndësishëm dhe aleat të pazëvendësueshëm siç është Gjermania", ka thënë Cufaj.



## Publikohen rezultatet e testit të maturës, kalueshmëria mbi 68 për qind

PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MASHTI) ka publikuar rezultatet e provimit shtetëror të maturës, të cilit i janë nënshtruar mbi 23 mijë nxënës të klasave të dymbëdhjeta në gjithë vendin. Sipas kësaj ministrie, kalueshmëria e testit të maturës është 68.43 për qind. "Këtë vit rezultati i përgjithshëm i kalueshmërisë është 68.43 për qind. Prej këtij rezultati, 68.36 për qind është kalueshmëria në mësimin në



gjuhën shqipe, 69.47 për qind në mësimin në gjuhën boshnjake dhe 74.77 për qind është kalueshmëria në mësimin në gjuhën turke", ka

njoftuar MASHTI, duke shtuar se rezultatet e provimit shtetëror të maturës tashmë janë shpërndarë në shkolla. Provimi i mbajtur më 26

qershor është organizuar në tri gjuhë: shqipe, boshnjake dhe turke dhe është mbajtur në 177 qendra të testimit. "Në këtë proces kanë qenë të angazhuar mbi 2 000 administrues, 550 komisionarë, 360 mbikëqyrës dhe 200 vëzhgues. Po ashtu, të gjitha qendrat e testimit janë monitoruar nga Këshilli Rinor Kosovar (KYC). Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit njofton se për shkak të përdorimit të telefonit, nga provimi janë larguar gjithsej 69 nxënës, të cilëve u është

anuluar testi", ka njoftuar MASHTI.

Kjo ministri ka bërë me dije se është duke i vlerësuar raportet e komisioneve në qendrat e testimit dhe se shpejti do të publikohen emrat e administruesve të cilët nuk kanë realizuar detyrën më përgjegjësi dhe ndaj të njëjtëve do të merren masa ligjore. MASHTI ka falënderuar të gjithë të përfshirët në procesin e mbajtjes së provimit shtetëror të maturës për kontributin dhe bashkëpunimin e tyre.

## Vetëm tri raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë regjistruar vetëm tri raste të reja me Covid-19 dhe asnjë rast i vdekjes. "Nga 1 105 testime, 3 qytetarë kanë rezultuar

pozitiv me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Sot janë shëruar pesë qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 105 381. Në total numri i rasteve aktive është

158", ka njoftuar MSh-ja. Po ashtu, MSh-ja ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 569 doza të vaksinës kundër Covidit. Sipas kësaj ministrie, deri më tani janë dhënë 206 443 doza të vaksinës kundër Covid. "Në

24 orët e fundit janë dhënë 569 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 206 443 doza të vaksinës. Deri më sot 49 616 qytetarë janë vaksinuar me



dozën e dytë", ka njoftuar MSh-ja.

## Familjarët e të pagjeturve kërkojnë të përfshihen në dialogun me Serbinë

PRISHTINË, 5 KORRIK - Familjarët janë shprehur të zhgënjyer me mënyrën se si çështja e të pagjeturve është trajtuar në takimin e parë në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Ndër katër pikat e propozuara nga Kurti në Bruksel për çështjen e të pagjeturve dhe të të zhdukurve me dhunë, ai ka kërkuar që të largohet nga pozita që ka dhe të merret në pyetje kreu i delegacionit serb, Veljko Odalović. Takimi i radhës në mes të Kosovës dhe Serbisë do të jetë më 25 korrik, ndërsa pritet që një takim i rangut më të ulët të ndodhë edhe gjatë kësaj jave. Familjarët kanë këmbëngulur që

kur të diskutohet çështja e të pagjeturve të jenë edhe përfaqësues të tyre si pjesë e delegacionit. Bajram Çerkini nga Qendra Burimore për Persona të Zhdukur ka deklaruar se ishte i zhgënjyer nga takimi i parë në mes të Kurtit dhe Vuçiqit. "Jam shumë i zhgënjyer sepse nuk është thënë, as nuk është përmendur ajo që është premtuar para se të shkojë në dialog. Më së pari të kishin kërkuar nga 'kasapi i Ballkanit' keqardhjen për atë çfarë ka ndodhur me trupat e pambrojtura të Republikës së Kosovës. Jo që kryeministri ia ka kërkuar faljen, por as keqardhjen, por e ka vendosur pikën e katërt për të cilën

familjarët janë të zhgënjyer me atë se çfarë është premtuar dhe me atë se çfarë është dashur të flitet", ka deklaruar Çerkini për "Ksp". Çerkini ka vlerësuar se delegacioni i Kosovës nuk ka shkuar i përgatitur mirë në takimin e parë, duke uruar të ndryshojë në takimet e ardhshme. Më tutje, Çerkini është shprehur se sa herë të flitet për persona të pagjetur, pjesë e delegacionit duhet të jenë edhe përfaqësuesit e familjarëve. "Edhe Slobodan Millosheviqi të ngrihet sot nga varri duhet të shkojmë e t'i themi: 'ku na keni lënë fëmijët?'. Tjetër janë ata përfaqësuesit që flasin në emër të familjarëve dhe nuk e ndiejnë në zemër si

familjari. Kur janë në pyetje personat e pagjetur, në Bruksel nuk shkohet pa familjarë. Shumë keq, por edhe shumë i papërgatitur sa i përket pikës katër të të pagjeturve. Sa është premtuar se do të flitet dhe të kërkohej falje, por edhe të kërkohej që të zbardhet fati i të pagjeturve nuk është thënë, por është dashur të jetë edhe një familjar. Me këto gjëra nuk është përgatitur sa duhet delegacioni ynë në krye me kryeministrin", ka deklaruar ai. Kurse kryetari i Këshillit Koordinues për të Zhdukurit dhe Krimet e Luftës, Ahmet Grajçevci, ka deklaruar se për familjarët është shumë e rëndësishme që të vihen para drejtësisë kryesit e krimeve të

luftës së fundit. "Së pari të kërkohej drejtësi e pastaj falje. Familjarët kërkojnë drejtësi edhe pasi të vendoset drejtësia bëhet kërkimfalja. Unë, sa kam kontaktuar me disa familjarë të Fushë-Kosovës, nuk kanë qenë të kënaqur. Kërkojnë më së pari që t'u kthehen më të dashurit e tyre sepse e dinë që janë në territorin e Serbisë, kërkojnë drejtësi, sepse drejtësia është ajo që e zgjedh gjithë problemin, e zgjidh edhe pajtimin. Më së pari duhet të ndriçohen të vërtetat pastaj të punojmë për paqe. Odalović është dashur që në fillim të shkarkohet sepse ka qenë komandant i shtabit të krizës dhe çdo gjë e ka ditur dhe çdo gjë e ka evidentuar vetë dhe çdo gjë e ka deklaruar Grajçevci.



## Zyrtari serb: Raundin e ri të bisedimeve e nisim me asociacionin



BEOGRAD, 5 KORRIK - Drejtori i të ashtuquajturës Zyrë Serbe për Kosovën, Petar Petković, ka deklaruar të hënë se raundi i ri i dialogut teknik me Prishtinën do të fillojë me temën e mosformimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Petković ka thënë se sot (e martë) bëhen saktësisht 3 000

ditë që nga nënshkrimi i marrëveshjes së Brukselit dhe, sipas tij, "Prishtina nuk ka përmbushur pjesën e saj të marrëveshjes dhe gjashtë pikat e para që i referohen Asociacionit". "Sigurisht që do të jetë tema kryesore për ne. Gjithashtu, ne do të flasim për të zhdukurit, sepse është një çështje e rëndësishme që

rëndon të dyja palët dhe nuk është vetëm një çështje politike, por edhe një çështje e civilizimit", ka thënë ai për "TV Happy". Sipas tij, një nga temat do të jetë marrëveshja për lirinë e lëvizjes sepse, siç ka thënë ai, Prishtina po e abuzon atë, si dhe marrëveshjet e tjera të nënshkuara.

# Pakoja e ringjalljes ekonomike, 50 milionë euro planifikohen të ndahen për punësim

PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Lëvizja Vetëvendosje, e cila qeverisë Kosovën, ka publikuar disa nga prioritetet e qeverisë Kurti në aspektin e punësimit në Kosovë. Sipas kësaj lëvizje, qeveria si masë në kuadër të ringjalljes ekonomike ka ndarë 50 milionë euro për çështjen e punësimit. "Me prezantimin e pakos për ringjalljen ekonomike, Qeveria e Kosovës ka treguar se për prioritet ka çështjen e punësimit. 50 milionë euro janë ndarë për krijimin e vendeve të reja të punës dhe për mbështetjen e drejtpërdrejtë të punëkërkuësve. 10 milionë euro qeveria do t'i ndajë për të gjithë ata dhe ato që kanë humbur vendin e tyre të punës përgjatë periudhës mars 2020 - prill 2021. Për çdo të ri të punësuar qeveria do ta subvencionojë pagën në 3 muajt e parë në vlerë prej 170 eurosh në muaj. 10 milionë euro qeveria do t'i ndajë për mbështetjen e secilit të punësuar të ri që nuk ka qenë i punësuar në 3 muajt e fundit e që deklarohet në ATK. Secilit prej tyre do t'u paguhen kontributet pensionale në vlerë prej

10-përqindësh të pagës për 12 muajt me radhë. 5 milionë euro për ta mbështetur punësimin e grave. Secilës grua që nuk ka qenë e punësuar në 3 muajt e fundit e që punësohet, do t'i subvencionohet 50 për qind e pagës për 3 muajt e parë, deri në maksimumin prej 150 euro në muaj. Pas periudhës tremujore, do të subvencionohet kontributi pensional", ka njoftuar Lëvizja Vetëvendosje. Më tutje, Vetëvendosja ka bërë me dije se 10 milionë euro do të ndahen për skemën e punësimit të rinjve. "10 milionë euro për ta filluar qysh këtë vit skemën e punësimit të garantuar për të rinjtë e moshave 18-24 vjeç, ku secilit të ri do t'i garantohet puna e parë, e subvencionuar nga shteti në nivelin e pagës minimale. 5 milionë euro për mbështetjen e trajnimeve dhe punësimin në TI. Për të orientuar talentet e reja drejt fushës së TI-së, do të ndahen kuponë me anë të cilëve mund të ndiqen kurse për TI apo trajnime në praktikë. Atyre që përfundojnë kursin apo trajnimin me sukses, do t'u ofrohet

## PAKOJA E RINGJALLJES EKONOMIKE



Masa e parë

### 50 MILIONË EURO MBËSHËTJETJE PËR PUNËSIM

10 MILIONË EURO PËR RIKTHIMIN E ATYRE QË KANË HUMBUR VENDIN E PUNËS GJATË PANDEMISË

10 MILIONË EURO PËR TA MBËSHËTETUR FORMALIZMIN E PUNËSIMIT

5 MILIONË EURO MBËSHËTJETJE PËR PUNËSIMIN E GRAVE

10 MILIONË EURO PËR SKEMËN E PUNËSIMIT TË GARANTUAR PËR TË RINJTË

5 MILIONË EURO PËR TRAJNIMIN DHE PUNËSIMIN NË TEKNOLOGJI INFORMATIVE

5 MILIONË EURO PËR TA MBËSHËTETUR PUNËSIMIN E PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

5 MILIONË EURO PËR SKEMËN E GRANTEVE PËR ZANATET

mbështetje në punësim për 3 muajt e parë. 5 milionë euro për punësimin e personave me nevoja të veçanta. Në funksion të arritjes së synimit për një shtet të barabartë për të gjithë, Qeveria e Kosovës do ta mbështesë secilin të punësuar me aftësi të veçanta me 50 për qind të pagës, deri në maksimum 150 euro në muaj. Mbështetja do të bëhet për 6 muajt e parë", ka njoftuar partia e Albin Kurtit. Po ashtu, Vetëvendosja ka bërë me dije se 5 milionë euro do të ndahen për skemën e granteve për zanatat. "Me qëllim të adresimit të shkallës së lartë të papunësisë në vend si dhe aftësimin profesional në zanate, qeveria do t'i mbështesë me grante për vetëpunësim të gjithë ata që janë të gatshëm të mësojnë aftësi të reja, për të cilat do të certifikohen. Vlera e këtyre granteve arrin shumën deri në 3 000 euro, ku granti do ta mbulojë blerjen e pajisjeve dhe themelimin e biznesit, pas përfundimit të trajnimit me sukses dhe certifikimit", ka njoftuar Lëvizja Vetëvendosje.

## ATK-ja dhe BKS-ja, marrëveshje bashkëpunimi



PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) kanë nënshkruar të hënën një marrëveshje bashkëpunimi. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj dhe ai i BKS-së, Sami Mazreku. Qëllimi i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit është shkëmbimi i të dhënave në mes të ATK-së dhe BKS-së në kohë reale për entitetet juridike në Republikën e Kosovës. Ky shkëmbim i të dhënave do ta mundësojë përmirësimin e ciklit të regjistrimit të mjeteve motorike në Kosovë si dhe shmangien e rasteve të mashtrimit dhe realizimin e procedurave të dëmshpërblimit të

palëve të dëmtuara në kohën dhe në masën e duhur, për të cilat veprime dhe procedura, BKS-ja është bartëse zyrtare. BKS-ja përmes kësaj marrëveshje obligohet që të gjitha detajet që lidhen me sigurimet e ndryshme, sipas kategorizimit të tyre, si dhe kompensimet e dëmeve për personat fizikë dhe juridikë, t'i ndajë në mënyrë elektronike me ATK-në, bazuar në specifikacionet e kërkuara nga kjo e fundit. BKS-ja, gjithashtu, duhet të ofrojë të dhënat për provizionet teknike, provizionet e arkëtueshme, rezervat, të hyrat nga primet e sigurimeve, risigurimeve, primeve të fituara, përfshirë numrin e veturave të siguruar dhe atyre jo të siguruar nga qytetarët dhe bizneset.

### ATK-ja publikon broshurën "Përmbushja tatimore"

PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), me qëllim që t'i njoftojë të gjithë personat lidhur me përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore, ka publikuar të hënën broshurën "Përmbushja tatimore". "Në një vend modern, që Kosova synon të jetë, nga qytetarët kërkohet pagesa e tatimeve dhe obligimeve të tjera të përcaktuara me ligj. Andaj, personat që zhvillojnë aktivitet ekonomik në Kosovë, në bazë të legjislacionit tatimor të Kosovës, janë të obliguar të regjistrohen, mbajnë dokumentacion, deklarojnë dhe paguajnë tatimin. Përmes kësaj broshure të gjithë personat do të informohen më për së afërmi për obligimet e tyre tatimore, si: mënyrën e regjistrimit, mbajtjes së dokumentacionit, deklarimit dhe pagesës së tatimeve dhe kontributeve konform legjislacionit tatimor në fuqi", ka njoftuar ATK-ja. Më tutje, ATK-ja ka theksuar se në vazhdimësi do t'i identifikojë personat të cilët iu shmangen detyrimeve tatimore. ATK-ja ka inkurajuar të gjithë personat që të deklarojnë dhe paguajnë detyrimet tatimore në mënyrë që të mos bëhen objekt i



ndëshkimeve.

Broshura "Përmbushja tatimore" është në dispozicion të tatimpaguesve në uebfaqen e

ATK-së "www.atk-ks.org", te vjegëza "multimedial", si dhe të njëjtën çdo person mund ta ketë edhe në formë fizike.



## Senatorja amerikane: Ka mënyra konkrete për zhvillimin ekonomik të Kosovës

PRISHTINË, 5 KORRIK(ER) - Senatorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) nga shteti i Iowas, Joni Ernst, ka thënë se ekzistojnë disa mënyra konkrete për ta avancuar zhvillimin ekonomik dhe bizneset në Kosovë.

Ernst në vizitën e saj në Kosovë është takuar me përfaqësuesit e Odës Ekonomike Amerikane në Prishtinë, ku ka theksuar mundësinë e bashkëpunimit të Kosovës me shtetin e Iowas në fushën e bujqësisë. "Ekzistojnë mënyra konkrete për avancimin e zhvillimit ekonomik dhe përkrahjen e bizneseve në Kosovë. Është me rëndësi të synohen fushat me mundësi më të mëdha për bashkëpunimin e zgjeruar ndërmjet Iowas dhe Kosovës, siç është bujqësia", ka thënë senatorja Ernst.

Ajo është shprehur e lumtur që

është kthyer në Kosovë dhe që mund t'i shpërndajë propozimet e saj lidhur me mënyrat sesi shteti prej nga ajo vjen mund ta ndihmojë Kosovën përtej bashkëpunimit ushtarak. Në këtë kontekst, ajo ka thënë se, përveç ekonomisë, mund të bashkëpunohet edhe në fushën e edukimit.

Derisa ka folur për zhvillimin e fuqisë punëtore, ajo ka theksuar rëndësinë e programeve të kualifikimeve profesionale për nxënësit si alternativë ndaj titujve universitarë, duke përmendur suksesin e programeve të tilla në Iowa.

Më tutje, Ernst ka theksuar se si këto programe përgatitin të rinjtë për tregun e punës, duke krijuar ndërlidhje më të mirë ndërmjet zhvillimit të shkathtësive me nevojat e punëdhënësve.

Lidhur me klimën e investimeve



në Kosovë, Ernst ka thënë se ka shumë njerëz të cilët do të kishin vullnet për të investuar dhe për t'u

angazhuar në Kosovë. Megjithatë, ajo ka thënë se investitorët kanë nevojë të sigurohen për një sistem

të fuqishëm ligjor, të mbështetur nga respektimi i demonstruar për sundimin e ligjit.

## BQK-ja: Ekonomia e Kosovës në vitin 2020 shënoi rënie për 3.9 për qind

PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Ekonomia e Kosovës është vlerësuar të ketë shënuar rënie prej 3.9-përqindësh gjatë pandemisë Covid-19 është thënë në raportin e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për vitin 2020. Sipas BQK-së, vendi është ballafaquar me rënie ekonomike pas një periudhe mjaft të gjatë të rritjes. "Në vitin 2020, sipas vlerësimeve tremujore të Agjencisë së Statistikave (ASK), ekonomia e Kosovës ka shënuar rënie vjetore prej 3.9-përqindësh", është thënë në raportin e BQK-së.

BQK-ja ka bërë me dije se rënia ekonomike ka ndodhur kryesisht si pasojë e sektorit të jashtëm të ekonomisë. "Rreziqet e rritura si pasojë e pandemisë dhe masat e ndërmarra për ta frenuar përhapjen e Covid-19 konsistuan kryesisht me masa kufizuese në udhëtim. Kjo është reflektuar në rënie të aktivitetit ekonomik, veçanërisht në tremujorin e dytë dhe të tretë, dinamika që u përkthye në rënie të theksuar në eksportin e shërbimeve në kuadër të bilancit të pagesave. Konkretisht, rënia e vizitave të diasporës në Kosovë si pasojë e drejtpërdrejtë e masave kufizuese për ta menaxhuar krizën shëndetësore ka rezultuar në rënie reale të eksportit të shërbimeve, duke ndikuar në thellimin e deficitit të eksporteve neto", është thënë në raportin e BQK-së.

Më tutje, raporti i BQK-së ka treguar se konsumi për vitin 2021 ka shënuar rritje. "Konsumi është vlerësuar të ketë shënuar rritje reale prej 6.7-përqindësh, mbështetur nga rritja e konsumit privat dhe konsumit publik", është thënë në



raportin vjetor të BQK-së. Sa i përket vitit 2021, parashikimet e BQK-së kanë sugjeruar se aktiviteti ekonomik në Kosovë do të rikuperohet drejt nivelit para pandemisë Covid-19. Megjithatë, sipas BEK-së, rreziqet ndaj aktivitetit ekonomik mbesin të larta. Sipas kësaj banke, kjo është e ndërlidhur me vaksinimin masiv të popullsisë kundër Covidit. "Sa i përket vitit 2021, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të rikuperohet drejt niveleve të para të krizës, me një rritje reale rreth 4.4 për qind. Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme dhe neto eksportet. Megjithatë, rreziqet ndaj aktivitetit ekonomik mbesin të larta, ndërlidhur me vaksinimin masiv dhe përmbylljen e pandemisë", është thënë në raportin e BQK-së. Për këtë vit niveli i çmimeve, sipas BQK-së, ka shënuar rritje prej 0.2-përqindësh, kurse për vitin aktual inflacioni pritet të jetë rreth 1.6 për

qind. "Rënia e kërkesës së përgjithshme dhe dinamikat në çmimet e mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare u reflektuan në presione të dobëta inflacioniste edhe në Kosovë. Niveli i përgjithshëm i çmimeve në vend, i shprehur nëpërmjet Indeksit të Çmimeve të Konsumit, ka shënuar rritje të ngadalësuar prej 0.2-përqindësh në vitin 2020. Për vitin 2021, norma mesatare e inflacionit pritet të jetë rreth 1.6 për qind", është thënë në raportin e publikuar nga BQK-ja.

Statistikat e tregut të punës në Kosovë, sipas BQK-së, kanë treguar për shkallë të lartë të normës së papunësisë, normë e cila ka mbetur pothuajse e pandryshuar krahasuar me vitin paraprak. "Shkalla mesatare e papunësisë deri në shtator 2020 ishte 25.60 për qind, një nivel pothuajse i ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit 2019 që ishte 25.57 për qind. Në vitin 2020 shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë

punëtore në Kosovë ishte 37.3 për qind që, krahasuar me vitin 2019, tregon për një rënie të shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore prej 3.2 pikë përqindje", është thënë në këtë raport.

Gjatë vitit të kaluar sektori i jashtëm i Kosovës është karakterizuar me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse në 480.7 milionë euro apo 7.1 për qind pjesëmarrje në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), me një rritje vjetore prej 20.4-përqindësh, kryesisht si pasojë e përgjysmimit të bilancit pozitiv të shërbimeve.

Në anën tjetër, rritja e eksportit të mallrave, si dhe rënia e konsiderueshme e importit si pasojë e rënies së aktivitetit ekonomik, ka ndikuar që deficitin në tregtinë e mallrave të shënojë rënie prej 9.4-përqindësh dhe të zbrësë në rreth 2.8 miliardë euro apo 41.5 për qind e PBB-së.

Për sa iu përket dërgesave nga diaspora, gjatë vitit 2020 ato janë rritur për 15.1 për qind. "Remitencat e pranuar në Kosovë arritën vlerën prej 980.1 milionë eurosh, që paraqet një rritje vjetore prej 15.1-përqindësh", është thënë në raportin e BQK-së.

Institucioni më i lartë financiar në vend në raportin e BQK-së ka treguar se investimet e huaja direkte për vitin e kaluar kanë shënuar rritje mbi 30 për qind. "Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë arritën vlerën prej 341.7 milionë eurosh, që paraqet një rritje të theksuar prej 34.2-përqindësh", është thënë në raportin e BQK-së. Kryeministri Albin Kurti në prezantimin e punës 100-ditëshe të Qeverisë së Kosovës kishte thënë se

ritja ekonomike për vitin 2021 pritet të jetë 7.9 për qind.

Kurti ka shtuar se brenda pesë muajve aktiviteti ekonomik është rritur për 15 për qind. "Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, eksporti është rritur 66 për qind, aktiviteti ekonomik 15 për qind dhe të hyrat buxhetore 30 për qind. Në pesëmuajorin e parë të këtij viti Dogana e Kosovës për herë të parë ka mbledhur mbi 500 milionë euro të hyra, ndërsa ATK-ja ka raportuar se ka inkasuar 60 milionë euro më shumë sesa në vitin e kaluar. Bazuar në këtë, Qeveria e Kosovës ka miratuar buxhet mbi 2.5 miliardë euro, sipas të cilit projektohet rritje ekonomike prej 7.9-përqindësh, për dallim prej 5.2-përqindësh që parashihej vitin e kaluar, prej të cilave buxheti do t'i shtohen 155 milionë euro më shumë nga çfarë parashihej", kishte thënë Kurti.

Ndërsa sipas Bankës Botërore, Kosova pritet të ketë rritje ekonomike 3.7 për qind në vitin 2021 dhe se rimëkëmbja do të jetë graduale, në përputhje me trendin botëror, aktiviteti real do të arrijë nivelet parapandemike vetëm në 2022.

Banka Botërore ka vlerësuar se pandemia ka ndërprerë përparimin e arritur gjatë një dekade në vendet e rajonit për rritjen e të ardhurave dhe uljen e varfërisë, ndërkohë që tregjet e punës në Ballkanin Perëndimor kanë mundur ta rikuperojnë vetëm gjysmën e vendeve të punës të humbura për shkak të pandemisë, duke lënë të papunë një numër të lartë personash dhe duke i detyruar shumë të tjerë ta braktisin tërësisht tregun e punës.

## Sektori i gjendjes civile në Mitrovicë do të punojë deri në orën 19:00

**MITROVICË, 5 KORRIK (ER)** - Nën kryesimin e nënkryetarit të komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, dhe në prani të drejtorëve të drejtorive komunale, të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e bordit të drejtorëve, në të cilën janë shqyrtuar një varg çështjesh me rëndësi për mitrovicasit.

Në këtë mbledhje drejtori i Inspeksionit, Fidan Ademi, ka njoftuar ekzekutivin lidhur me vizitat dhe kontrollimin e lokaleve të natës nga inspektorët komunalë me qëllim të shmangies së ndotjes akustike si pasojë e volumit të muzikës dhe

kontrollimin e nivelit të zhurmës nga këto lokale. "Drejtoria e Inspeksionit, pas adresimit të kërkesave dhe shqetësimeve të qytetarëve si pasojë e nivelit të lartë të muzikës, edhe gjatë këtij vikendi ka inspektuar lokalet e natës në mënyrë që të evitohet ndotja akustike si pasojë e nivelit të lartë të zhurmës, ku drejtoria jonë shumë shpejt do të ketë në posedim edhe pajisjen e cila do ta identifikojë nivelin e zhurmës. Komuna nuk ka për qëllim që të pengojë veprimtaritë e këtyre bizneseve, por që të ketë disiplinë dhe të ruhet qetësia publike e qytetarëve", ka thënë Ademi.

Më tutje, ai ka propozuar që të bëhet plotësim/ndryshimi i Rregullores Komunale për Mbrojtjen e Mjedisit 02/2010, respektivisht neni 15 për mbrojtje nga zhurma, që të specifikohet lartësia maksimale e zhurmës konform standardeve evropiane, ndërsa për të gjithë kundërvajtësit do të shqiptohen gjopa të rrepta.

Ndërsa drejtori i Bujqësisë, Ekrem Sadiku, ka potencuar se pas reshjeve të shiut që kapluan qytetin e Mitrovicës, së bashku me ministrin e Bujqësisë, Faton Peci, gjatë këtij vikendi kanë qëndruar për vizitë te fermerët të cilët pësuhan dëme nga këto reshje.



Në anën tjetër, drejtoresha e Administratës, Valmire Sylejmani, ka informuar bordin e drejtorëve se për të ofruar shërbime sa më

cilësore dhe të shpejta, sektori i gjendjes civile do të punojë deri në orën 19:00, duke përfshirë këtu edhe kohën e pauzës.

## Kilaj, kandidat i PDK-së për kryetar të Malishevës: Po mos të besoja në fitore, nuk do të konkurroja



**MALISHEVË, 5 KORRIK (ER)** - Kryetari i Degës i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Malishevë, Isni Kilaj, do të jetë kandidat i kësaj partie për kryetar të Malishevës në zgjedhjet e 17 tetorit të këtij viti. Kandidatura e Kilajt ka marrë mbështetjen e Kryesisë së Degës së PDK-së në Malishevë. Sipas dokumentit të siguruar nga "Epoka e re", vendimi i kandidaturës së Kilajt, i është

përcjell kryetarit të ri të PDK-së, Memli Krasniqi.

Pas publikimit të këtij vendimi, Kilaj, në një prononcim për "Epokën e re", është shprehur i bindur se do t'i fitojë zgjedhjet e 17 tetorit në Malishevë. Ai ka thënë se i njezh rrethanat brenda partive të tjera në këtë komunë. Në këtë kontekst, ka thënë se po të mos ishte i bindur në fitore, nuk do të garante për kryetar të

Malishevës.

"E them me bindje të plotë se do të dal fitues në këto zgjedhje. I njoh rrethanat te partitë e tjera dhe kandidatët e tyre pretendentë për kryetar të Malishevës. Po të mos besoja në fitore, nuk do të konkurroja", ka thënë Kilaj.

Isni Kilaj ka përvojë të gjatë politike, sidomos në atë komunale, pasi ka qenë kryetar i komunës së Malishevës.

## Nesër rivarrosen tetë dëshmorë në Morinë të Gjakovës

**GJAKOVË, 5 KORRIK (ER)** - Dega e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së në Gjakovë ka njoftuar se nesër (e mërkurë) do të bëhet rivarrimi i tetë dëshmorëve në Morinë të Gjakovës. Dëshmorët që do të rivarrosen janë: Muhamet Imer Ukshini, Shkelzen Sylë Sylja, Blerim Bajram Ukshini, Sylejmon Mustaf Abdyl, Nezir Halim Elezaj, Ahmet Idriz Pulatani, Arben Avdyl Ukshini dhe Ymer Muhamet Bytyqi. "Të nderuara familje të dëshmorëve, invalidë dhe

veteranë të UÇK-së, qytetarë të komunës së Gjakovës dhe të gjitha trojeve shqiptare, ju njoftojmë se të mërkurën, më 07.07.2021, në orën 11:00, me rastin e 23-vjetorit të rënies, bëhet rivarrimi i tetë (8) dëshmorëve të rënë në fshatin Morinë. Ceremonia e rivarrimit do të bëhet në kompleksin memorial të dëshmorëve në fshatin Morinë të Gjakovës, në rrugën Ponoshec - Qafë-Morinë", ka njoftuar Dega e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së në Gjakovë.



## Komuna e Vitisë organizoi takim lamtumirës për ushtarët amerikanë

**VITI, 5 KORRIK (ER)** - Me rastin e përfundimit të mandatit disamujor të Njësisë LMT, në kuadër të ushtrisë amerikane të KFOR-it, të hënën zëvendëskryetari i komunës së Vitisë, Hasan Aliu, ka pritur në takim rreshterët Seidel dhe Stab, të cilët i ka

falënderuar për punën e deritanishme në këtë komunë. Po ashtu, Aliu iu ka dëshiruar mirëseardhje rreshterit të stafit, Dayon dhe specialist Parah. Më tutje, ushtarët amerikanë të KFOR-it janë njoftuar me aktivitetet e komunës së Vitisë si dhe


për planet në të ardhmen. Njësisia e LMT-së që funksionon në kuadër të KFOR-it vazhdon të jetë një mekanizëm bashkëpunues në mes të autoriteteve komunale dhe komandës së KFOR-it amerikan në "Bondsteel".



## Skënder Karriqi: Një skicë e prometeikes në letërsinë shqipe, nga De Rada tek Poradeci

Kur është fjala për shtjellimin e temës prometeike në letërsinë shqipe të Rilindjes Kombëtare dhe të Pavarësisë, që në fillim ndeshesh me mungesën e pranisë së drejtpërdrejtë të heroit mitologjik, titanit Promete, edhe pse ai është universalizuar përgjatë shekujve letrarë. Tek asnjë nga autorët e këtyre dy periudhave letrare nuk rimerret Prometeu dhe miti i tij në kuptimin e subjektit letrar, me anë të të cilit të parabolizohen ide të Rilindjes Kombëtare apo të Pavarësisë. Gjithashtu ai nuk përmendet si hero modelues apo frymëzues, në një kohë që formimi kulturor dhe letrar i autorëve të të dyja periudhave dëshmon njohjen e antikitetit klasik dhe periudhave të mëvonshme kulturore-letrare evropiane e më gjerë. (Duhet përjashtuar këtu rasti i Konicës, për të cilin do të shprehemi më poshtë, sa na lejojnë përmasat e këtij shkrimi).

Gjithsesi, në letërkëmbime apo biseda, siç është rasti i De Radës, Prometeu përmendet në mënyrë të atillë metaforike, me të cilin autori vetidentifikohet, duke shenjuar me figurën e titanit gjithë aktivitetin e vet letrar dhe joletrar, por gjithsesi, politik. Po në krijimtarinë poetike të De Radës, këtij themeluesi të letërsisë së mirëfilltë artistike shqiptare, gjejmë hijen e Prometeut tabu, të eufemizuar si perëndia që nxori njeriun në dritë, shohim gjithashtu, ngjashëm me Gëten, figurën e krijuesit që gjen brenda vetes pishtarin me të cilin ai do t'u ndriçojë brezave udhën e lirisë dhe të progresit. Këtë ndjesë të brendshme De Rada do ta ngrejë në nivelin e një parimi estetik, që duhet të dallojë cilësisht veprën letrare. Tek krijimtaria poetike e De Radës e ka zanafillën edhe heroit lirik shqiptar, i sublimuar në hapësira dhe distanca majëmalesh, kodrash, brigjesh, çukash, timbash etj, veçori romantike kjo, të cilën studiuesit e shohin të lidhur në pikëpamje gjenetike, me serinë e imazheve të Prometeut të lidhur në shkëmbin e Kaukazit. Së fundi, gjejmë tek De Rada, projektin ideal të Shqipërisë së pavarur, asociuar me imazhin dritësor të yjeve dhe të ditës së bardhë. Ky projekt ideal i De Radës për të ardhmen e Atdheut të të parëve s'ka se si të mos jetë i lidhur me dritën shkëlqimtare që i jep kuptim ati (projektit) ngjashëm me projektet ideale të



romantikëve evropiane, veçanërisht preromantikut Gëte.

Në krijimtarinë poetike të Naim Frashërit, ideja dhe disponimi prometeik vijnë me metaforën e qiririt, që sakrifkohet për ndriçimin dhe vëllazërimin e njeriut, si dhe nëpërmjet metaforës së fyellit, si parabol e heroit të pakuptuar, që vuan për njerëzit, por më shumë vuan faktin që është i pakuptuar prej tyre. Gjithashtu, Naim Frashëri, në mënyrë qartësisht poetike, vjen edhe si heroit lirik i sublimuar në lartësi majëmalesh dhe në marrëdhënie me distanca hapësinore, nga ze fill poetizimi i atdheut. Kaq mbresëlënës është imazhi sublim i tij në këto rrëthana, sa ai dominon gjithë krijimtarinë poetike naimjane, pas botimit të poemës *Bagëti e Bujqës* (1886). Është imazhi prometeik me të cilin vetëpoetizohet poeti i atdheut. Në imazhin prometeik të poetit që mediton në distancë majëmali duke sjellë perceptimin poetik të fshatit *.../... me kish' e me varre, / Rrotull ca shtëpi / Të vogëla fare /*, shenjë kjo e poetikës së distancës romantike në raport me objektin poetik, vjen edhe Çajupi me vëllimin *Baba Tomorri*. Pikërisht nga kjo distancë majëmali heroit lirik mediton për gjendjen e mjeruar të gruas shqiptare dhe stigmatizon moralin maskilin, që e legjitimon atë gjendje.

Tek poemthi *Liria*, Mjeda do të vijë me imazhim e heroit prometeik të izoluar. Edhe pse në rrëthana të tilla, ai e tejkalon shërbëtorin e Zotit dhe i drejtohet simbolit totemistik të shqiptarëve, Shqipes, për të mësuar të ardhmen e lirisë së popullit shqiptar. Më pas teksti

modelohet në mënyrë të atillë, që eklipson dialogun e Shqipes me poetin. Në mënyrë të nënkuptuar, thelbi i këtij dialogu është informacioni mbi lirinë e Atdheut dhe të ardhmen e tij, informacion ky që vjen së larti; jo nga muza antike apo Zoti unik, por nga totemi i shqiptarëve, falë topikës dominuese në lartësi dhe hapësirë. Në këtë mënyrë autori legjitimon vetën prometeike si trumbetar i lirisë, hero prometeik që zgjon politikisht popullin dhe e orienton zemërimin e tij për kah liria.

Në poezinë e Nolit, prometeikja vjen në imazhin e çlirimtarit, por dhe heroit të pakuptuar, nëpërmjet poetizimit episodik të subjektit biblik mbi jetën e Mojsiut dhe Jezus Krishtit, përkatësisht në poezitë: *Mojsiu në mal, Krishti me kamçikun, Marshi i Krishtit, Marshi i Kryqësimit dhe Kryqësimi*. Në poezinë *Anës lumenjve*, heroit prometeik nolian vjen në imazhin e të syrgjynosurit, (parabol për vetveten) si figurë mesianake, që paralajmëron lëvizjen e gjerë politiko-sociale që do të sjellë lirinë e vërtetë. Në këtë poezi konfirmohet në një regjistër të admirueshëm poetik veta prometeike. Sipas modelit titanik janë paraqitur edhe figura nga antikiteti grek dhe historia e Shqipërisë (periudha e viteve 20-të, kur vetë poeti ishte protagonist në skenën politike shqiptare). Në imazhin heroik të lajmëtarit të fitores, që do të thotë lirisë, vjen Maratonomaku, i detajuar në përmasa titanike nëpërmjet hiperbolës: *Gryka si gjyryk të çfryn / Prej vullkani flag e tym /*. Po në përmasa të tilla titanike, duke shtuar edhe përmasën sociale, metaforizohen e detajohen edhe bashkëlufëtarët e poetit, si Bajram Curri: *Dif dragoj i*

*Dragobisë, / Trim tribun i Vegjëlisë. .../ Legjendar Ante po rritesh- /*, apo Luigj Gurakuqi: *Ky Vigan Liberator!*.

Konica, ndër të paktët që në esenë *Jeta dhe librat* sjell në vëmendjen e lexuesve figurën e Prometeut dhe vlerëson tragjedinë e Eskilit, në *Katër përalla nga Zullulandi*, vjen me historinë prometeike të Plugut, (edhe këtu parabol për vetveten) i cili, pas përpjekjeve të mundimshme për të zgjuar ndërgjegjen politiko-sociale të fisit të tij, Zulluve, përmidjet nga turma e paditur, që udhëhiqet nga demagogu injorant Deni Sepa Llupa dhe detyrohet të ngujohet në shpellë, duke përkuar në këtë mënyrë (ngjashëm si tek Noli) me mesianizmin social që kemi parë në variante evropiane.

Ndërsa heroit prometeik i Koliqit, edhe pse vjen nga Perëndimi me ideale të qarta dhe i vendosur t'i përkushtohet qytetërimit të mjedisit social konservator, nga ku ka origjinën, nuk arrin ta tejkalojë *Hijen e maleve*, duke mbetur thjesht një shembull argumentues i teorisë psikanalitike mbi rrënjët e moralit zakonor në subkoshiençë.

Përveçse tek Koliqi gjejmë imazhin e heroit lirik që mediton në majëmalesh, ngjashëm me modelin prometeik, në *Pasqyrat e Narcizit* distanca perspektive romantike vjen ngjashëm edhe me modelin e Narcizit. Kështu sipërfaqja e pellgut të çuterit (kroit), pusit, liqenit, apo sipërfaqja e një pasqyre, imazhohet si hapësira informacioni mbi të cilin mediton heroit lirik, për të arritur tek rrënjët e tij etnike.

Edhe pse tek Migjeni vihet re predispozita prometeike e heroit lirik të angazhuar në lidhje me probleme të mprehta sociale,

përgjithësisht ai nuk e tejkalon pesimizmin, duke mbetur figura e vetës poetike të pafuqishme përballë *malit* që *hesht* dhe *qesht* me të. Ai nuk arrin të shfaqet në përmasa titanike për ta tejkaluar këtë mal, nuk e tejkalon dot dhomën e erret dhe në vend që të gjejë brenda vetes pishtarin, kërkon dritë. Ndoshta që sëmundja që e pengoi këtë zë poetik të fuqishëm denoncues, të arrijë përmasat prometeike. Nga ana tjetër sensi realist mund ta ketë penguar atë t'i referohet modelit romantik të heroit lirik, i konceptuar poetikisht ngjashëm me modelet mitologjike titanike.

Lasgush Poradeci e ndërton parabolën prometeike sipas modelit natyror dhe të Gjenit. I pari mishërohet poetikisht në poezinë *Vdekja e Nositit*, nëpërmjet së cilës vetëflijimi poetizohet si rregull tragjik i vazhdimësisë së brezave. Ndërsa i dyti sendërtohet në poezinë *Gjeniu i anijes*, ku spikat akti vetflijues i Gjenit për të hapur rrugë të pashkelura të filozofisë së triumfit mbi vështirësitë e jetës: *Se po lë vazhden e ndritur- / Q'e hapa me shpirtin fatos- / Fiston gazmor ku pat shkitur / Valim-anijes q'u sos. /*

Ky vështirim i shkurtër përgjatë dy periudhave të letërsisë shqipe, Rilindjes dhe Pavarësisë, është i mjaftueshëm për të konstatuar praninë e prometeikes si strukturë karakterizuese, e cila dëshmoheq qartë nëpërmjet vetës së parë, topikës së sublimimit të heroit lirik në maja malesh, kodrash, bregoresh, timbash etj, metaforës, dhe alegorisë, duke reflektuar një sens të qartë parabolik. Është pikërisht prania konstante e kësaj strukture, me të cilën lidhet fryma prometeike, që karakterizon letërsinë e këtyre dy periudhave letrare, në pikëpamje përmbajtësore, si një letërsi e angazhuar për ringjalljen e idesë kombëtare (Rilindja) dhe emancipimin e shoqërisë shqiptare (Pavarësia).

Bërthama e këtij angazhimi letrar është autori, i cili, përveçse transfigurohet brenda subjektit epik apo lirik më së shpeshti nëpërmjet vetës së parë, përndryshe vetës prometeike, edhe kur shprehet në vetën e tretë, e realizon këtë transfigurim nëpërmjet rastit autobiografik, si raport i vetës autoriale me masën, shoqërinë në një moment të caktuar historik. Pikërisht nga ky raport angazhues përftohet figura e autorit hero, misionar, për të ndriçuar e hapur perspektiva të reja kombëtare e sociale.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Sot gjysmëfinalja e parë Itali - Spanjë



LONDËR, 5 KORRIK - Italia dhe Spanja do të përballen sonte (e martë) nga ora 21:00 në gjysmëfinalen e parë të Kampionatit Evropian "Euro 2020". Duke parë ecurinë e këtyre dy kombëtareve, ndeshja që do të zhvillohet në "Wembley" pritet të jetë jashtëzakonisht interesante, ku të dyja këto skuadra do ta kërkojnë plasmanin në finalen e madhe që zhvillohet më 11 korrik. Përballja mes tyre është e shtatë, ndërkohë e katërta herë me radhë që Evropiani rezervon një duel të tillë në fazën me eliminim direkt. Për herë të fundit të "axurrët" dhe "La Furia Roja" u përplasën në 1/8 e "Euro 2016", kohë kur Italia bënte surprizën dhe kualifikohej me golat e Giorgio Chiellinit dhe Graziano Pele. 13 000 tifozë do të mund ta ndjekin gjysmëfinalen e parë të kampionatit Evropian në mes të

Italisë dhe Spanjës në "Wembley". UEFA ka bërë me dije se tifozët e të dyja skuadrave nuk do të kenë në dispozicion më shumë se 6 400 bileta secila për shkak të kufizimeve sa iu përket aktiviteteve ndërkombëtare në Britaninë e Madhe. Në finalen e "Euro 2020" do të jenë të pranishëm vetëm ata italianë apo spanjollë që jetojnë në ishull, ndërkohë që "Wembly" do të jetë i hapur për 60 mijë britanikë, thënë ndryshe, do të shfrytëzohet deri në 75 % e kapacitetit. Ylli i Italisë, Federico Chiesa, ka thënë se kjo ndeshje është mjaft e vështirë për të dy kombëtarët. "Kundër Spanjës do të jetë një ndeshje shumë e vështirë. Ata e mbajnë shumë topin, ashtu si ne dëshirojmë. Do të jetë një ndeshje e vështirë, por si të gjitha të tjerat që kemi kaluar deri më tani. Ne nuk

frymëzohemi nga Spanja, por kanë një filozofi të ngjashme me ne, të mbajnë topin, të bëjnë presing ofensivë, përpiqen ta dominojnë kundërshtarin. Ne kemi një mesfushë fantastike. Për ne sulmuesit është bukur të kesh një mesfushë të tillë pasi topi të vjen gjithnjë në kohën e duhur", ka thënë Chiesa.

Për këtë ndeshje foli edhe trajneri i Spanjës, Luis Enrique. Trajneri spanjoll e ka lavdëruar lojën e italianëve. "Është gjithmonë e më e vështirë. Besoj se Italia është një skuadër argëtuese, që luan një futboll të bukur. Mban tipin dhe di të ushtrojë presing si sipër në sulm, ashtu edhe pranë zonës së saj. Është një skuadër e vështirë për t'u përballur. Do të jetë një ndeshje e vështirë, me intensitet dhe pasion", ka deklaruar Enrique.

## "EURO 2020"

### Erikseni, lojtarëve të Danimarkës: Jam krenar për ju

Gazeta italiane "Gazzetta dello Sport" raporton se mesfushori Christian Eriksen ka dërguar mesazh në grupin e "Whatsapp" të bashkëlojtarët e Danimarkës pas fitores ndaj Republikës Çeke. Eriksen ra pa ndjenja në ndeshjen e parë ndaj Finlandës, pas një arresti kardiak por, fatmirësisht, doli të shpëtojë. Sipas "Gazzetta dello Sport", 29-vjeçari ka dërguar mesazh të bashkëlojtarët pas fitores 2-1 ndaj Republikës Çeke. Eriksen ka shkruar: "Jam krenar për ju". Danimarka në gjysmëfinale do të takohet me Anglinë. Fituesi i kësaj ndeshje do të arrijë në finale të "Euro 2020", ku do të takohet me fituesin e takimit Itali - Spanjë.

### Kjaer: Danimarka ka synuar gjysmëfinalen, tani dëshiron më shumë

Mbrojtësi i Milanit, Simon Kjaer, ka thënë se qëllimi i Danimarkës ka qenë arritja në "Wembley", por ai ka bërë me dije se tash synimet e danezëve janë rritur dhe synojnë një sukses historik në Kampionatin Evropian. "Qëllimi ynë ishte të shkojmë në 'Wembley'", ka thënë Kjaer për UEFA.com. "Do të gënjeja nëse do të thosha se kjo është mjaftueshëm për ne sepse ne kemi arritur në gjysmëfinale. Tani po mendojmë për t'u rikuperuar për shkak se pas katër dite ne do të kemi një ndeshje të rëndësishme për ta luajtur. Ne kemi luftuar me thonj dhe dhembë. Ne do të mund të luanim një ndeshje edhe më të mirë, sepse po lëmë kundërshtarët tanë ta marrin iniciativën por, fatmirësisht, ne kemi arritur që të mbrohemi mirë", ka shtuar Kjaer.

### Belgjika nuk e largon Martinezin

Roberto Martinez do të qëndrojë si shef i Belgjikës në Kupën e Botës 2022, pavarësisht se i ashtuquajtur "brez i artë i kombit" pësoi një tjetër dështim të madh të turneut në "Euro 2020". Ata u përkulën në fazën çerekfinale pas një humbje ndaj Italisë, duke çuar në pyetje se sa kohë do të qëndrojnë figurat kryesore ende brenda ekipit. "Sot ne fillojmë përgatitjet për lojërat shtator dhe tetor. Roberto Martinez do të jetë atje. Asnjë komunikim zyrtar nuk do të ndjekë, por nuk ka asnjë arsye për ta ndryshuar stafin", ka thënë shefi ekzekutiv i Belgjikës, Peter Bossaert.

## UEFA sqaron se kush qëndron në vendin e parë si golashënues në 'Euro 2020'

Patic Schick shënoi golin e tij të pestë në "Euro 2020" në ndeshjen e fundit të Republikës së tij Çeke, të eliminuar në çerekfinale kundër Danimarkës. Ish-sulmuesi i Romës ka arritur

kështu vendin e parë të shënuesve më të mirë bashkë me Cristiano Ronaldo, i cili edhe ai është ndalur në kuotën e pesë golave. UEFA e ka bërë të qartë se kush do të fitojë "Këpucën e Artë" në këtë rast.

Nëse do të ketë barazim golash, konsiderohen asistimet vendimtare dhe momentalisht krye-golashënuesi i Kampionatit Evropian është Ronaldo pasi ka pesë gola, por edhe një asistim, ku për CR7

llogaritet asistimi i dhënë për Diogo Jotan kundër Gjermanisë. Zyrtarisht ende nuk ka mbaruar asgjë pasi mund të ketë ende rrezik për Ronaldon pasi janë Kane, Sterling, Dolberg me tre gola

dhe që kanë shanse ende për të shënuar. Ndërkohë edhe Insigne, Locatelli, Immobile me dy gola tek Italia dhe Ferran Torres, Morata e Sarabia te Spanja me dy të tillë kanë shanse teorike.

## Hoxha paraqitet te Lokomotiva

PRISHTINË, 5 KORRIK - Sulmuesi Arbër Hoxha është larguar nga Ballkani për ta vazhduar karrierën në Kroaci, përkatësisht në skuadrën e Lokomotivës së Zagrebit. Lajmi

është publikuar nga klubi kroat, por edhe nga vetë futbollisti Hoxha. "20-vjeçari i Kosovës, Arbër Hoxha, lojtari më i ri i Lokomotivës. Arbëri ka shënuar 21 gola në 98 ndeshje në

Superligën e Kosovës. Mirë se erdhe, Arbër!", thuhet në njoftimin e Lokomotivës. Ndërsa ish-futbollisti i Istogut, Prishtinës dhe Ballkanit ka shkruar në profilin e vet në

"Facebook": "Nga sot fillon një kapitull i ri në karrierën time, një aventurë e re me sfida të reja. Me ndihmën e Zotit shpresoj që çdo gjë të shkojë në mënyrën e duhur".



## Eroll Salihu zgjedhet kryetar i Komisionit të Arbitrazhit Sportiv

PRISHTINË, 5 KORRIK - Komisioni i Arbitrazhit Sportiv (KAS), që vepron në kuadër të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), ka mbajtur edhe mbledhjen e dytë në të cilën janë zgjedhur organet drejtuese: kryetari, nënkryetari dhe sekretari për mandatin 2021-2024. Kryetar është zgjedhur Eroll Salihu, i cili ka përvojë si jurist dhe në menaxhimin e organizatave sportive. Salihu është sekretar i përgjithshëm i Federatës së Futbollit të Kosovës, njëherësh anëtar i Komitetit Ligjor i UEFA-së. Nënkyetar është zgjedhur Armend Krasniqi, ndërsa sekretare Jehona Shyti. Të nëntë anëtarët që e përbëjnë KAS-in janë juristë, të cilët janë zgjedhur në Asamblenë e fundit Zgjedhore të KOK-ut, pas propozimeve të ardhura nga federatat sportive. Në kuadër të KAS-it funksionon edhe



rregullorja për procedurat e zgjidhjes së konflikteve, e miratuar në Asamblenë e Punës së KOK-ut. Funksionalizimi i KAS-it është i rëndësishëm për federatat sportive, për klubet dhe gjithë sportin e Kosovës, sepse zgjidh të gjitha konfliktet mes federatave, klubeve dhe sportistëve.

## Shatri: Jemi në një mision historik

PRISHTINË, 5 KORRIK - Kosova A në konkurrencën e femrave është duke vazhduar përgatitjet për Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla. Kjo është hera e parë që Kosova A te femrat do të garojë në arenën ndërkombëtare zyrtarisht. Përzgjedhësi Fidan Shatri ka folur për rëndësinë që ka pjesëmarrja në këtë garë. "Kjo është hera e parë që marrim pjesë si Kosova A te femrat. Fillimisht është shumë mirë që është formuar Kosova A dhe të marrë pjesë në garat ndërkombëtare. Kjo është një mundësi shumë e mirë për basketbollistët me përvojë, por edhe lojtarët e reja ta përfaqësojnë vendin në garat ndërkombëtare. Është hera e parë dhe sigurisht se është shumë e veçantë", ka thënë Shatri për faqen zyrtare të FBK-së. "Ne kemi për synim ta japim maksimumin në çdo ndeshje që



paraqitemi. Të japim më të mirën tonë, sepse e dimë rëndësinë për ta përfaqësuar shtetin. Është nder dhe krenari për të gjithë ne", ka shtuar Shatri. Kosova është në grup me Qipron dhe Luksemburgun. "Nuk ka ndeshje të lehta, sidomos kur kemi parasysh se nuk kemi shumë përvojë ndërkombëtare. Kemi një ekip me lojtare me përvojë dhe të reja. Ne duam të lëmë gjurmë në këtë garë", nënvizon përzgjedhësi i Kosovës A (femrat). Kampionati Evropian për Shtete të Vogla zhvillohet nga 20 deri më 25 korrik. Vashat dardane janë në grup me Qipron dhe Luksemburgun, kurse në tërësi marrin pjesë shtatë shtete.

### SHKURT

#### Tare rikthen te Lazio sulmuesin Anderson

Lazio është pranë një rikthimi të bujshëm. Igli Tare ka vendosur të investojë për të kthyer Felipe Andersonin në Romë dhe bisedimet janë në rrugën e duhur. Fabrizio Romano bën me dije se trativat me West Hamin janë drejt finalizimit me sukses dhe shumë shpejt kalimi te Lazio do të mbyllet dhe braziliani do të rikthehet në "Olimpico". Edhe vetë lojtari e dëshiron rikthimin te Lazio, ku trajner tashmë është Mauricio Sarri. Kontrata e 28-vjeçarit përfundon verën e shkuar dhe Tare mund ta blejë me një shifër modeste. Anderson ka luajtur pesë vjet te Lazio në periudhën 2013-2018, ku ishte një nga më të mirët e ekipit kryeqytetas para se të shitej në Londër për plot 38 milionë euro.

#### Balotelli, afër transferimit në Turqi

Presidenti i Adana Demirspor, Murat Sancak, zbuloi se ata pothuajse kanë arritur një marrëveshje me Mario Balotellin. Sulmuesi është një lojtar i lirë këtë verë, pasi ai u largua nga Monza shkaku që i skadoi kontrata e tij gjashtëmujore. Ai është lidhur me një kalim në Adana Demirspor, të cilët sapo janë promovuar në Superligën e Turqisë. "Me Balotellin ne pothuajse kemi arritur një marrëveshje", ka thënë Sancak për "A Spor". "Le të themi që jemi në 85 për qind (të marrëveshjes). Mario na ka thënë që dëshiron të bashkohet me ne. Ai do të vijë në Turqi javën tjetër. Nëse gjejmë një marrëveshje, atëherë ai do ta veshë fanellën tonë. Ai dëshiron të jetë i suksesshëm me ne për të shkruar në Kupën e Botës në Katar", ka shtuar Sancak.

#### Hamiltoni: Do të luftoj deri në fund për titullin

Lewis Hamiltoni përdori "Instagramin" për ta dhënë mesazhin e tij për ata që e konsiderojnë tanimë të mposhtur nga Max Verstappen. Holandezi i Red Bullit po e mposht kampionin e botës me pesë suksese në 9 raundet, 3 të fundit radhazi. Anglezi gjithsesi s'ka ndër mend ta ngrëjë flamurin e bardhë, të paktën jo pa dhënë gjithçka për ta mbrojtur fronin e tij pas katër vjetësh dominimi. "Në momente si ky duhet të jemi veçanërisht të vëmendshëm, të përqendruar dhe të vendosur. Dorëzimi nuk është kurrë një opsion. Këto pesë garat e fundit kanë qenë vërtet të vështira, por mbetem optimist dhe besimplotë te skuadra ime. Jam i sigurt se do të ringrihem shpejt, tani për takimin e radhës", ka shkruar Hamilton.

#### Sërish dy raste me Covid-19 në Olimpiadë

Dy raste të reja me Covid-19 janë konfirmuar në orët e fundit në radhët e sportistëve që kanë mbërritur në Tokio, ku më 23 korrik do të nisnin Lojërat Olimpikë. Bëhet fjalë për dy sportistë serbë të garave me vela. Ishte Milos Vasiq ai doli pozitiv pas mbërritjes në Japoni dhe ishte pa simptoma. Ai hyri menjëherë në izolim ashtu sikurse edhe pjesa tjetër e delegacionit të këtij sporti edhe pse ata dolën negativë. Më vonë u konfirmua edhe një rast i dytë nga delegacioni serb (nuk dihet emri i personit) dhe të dy personat janë në karantinë për 7 ditë. Personat kishin rezultuar negativë para nisjes për Japoni, por dolën pozitivë pasi mbërritën në Tokio. Ky është rasti i dytë brenda pak ditësh me koronavirus në radhët e sportistëve që kanë mbërritur në Tokio. Më herët patën dalë pozitivë dy sportistë nga Uganda.

## Anelka, Mbappes: Nëse e dëshiron 'Topin e Artë', largohu nga PSG-ja

E ardhmja e Kylian Mbappe vazhdon të jetë çështja kryesore në merkaton e futbollit. I fundit që foli për këtë temë ishte një ish-lojtar i Real Madridit, Nicolas Anelka. Francezi ka shkruar një letër për "The Athletic", në të cilën këshillon bashkatdhetarin e tij

që të largohet nga PSG-ja. "Nëse dëshiron të marrësh vlerësimet më të larta, do të duhet të largohesh nga PSG-ja në një moment. Çfarëdo që të bëni në Paris do të jetë e mirë, por dikush gjithmonë do të thotë: Epo, keni bërë shumë mirë me PSG-në, por vetëm

në Francë. Yjet luajnë në Angli dhe Spanjë, kështu që ju nuk keni garuar me lojtarët më të mirë", ka shkruar Anelka. "Ju keni dy zgjedhje, të qëndroni në Paris ose të shkoni te Real Madridi. Pra, do të duhet të vendosni. Nëse dëshironi të fitoni "Topin e Artë", çka duhet

të kërkonte pas Cristiano Ronaldos dhe Lionel Messit, do të duhet të garoni me më të mirët. Liga franceze nuk është e lehtë, mos më keqkupto, por mendoj se liga më e vështirë është Premierë Ligë, pastaj Spanja. Nëse dëshiron të jesh një nga më të mirët, bëj atë që

bën në Paris, por me Chelsea, Manchester United, Arsenal, Manchester City ose Liverpool. Ndryshe shko në Spanjë te Real Madridi ose Barcelona, apo ndoshta Itali. Pastaj mund të flasim për një ndikim më global", ka shkruar Anelka.



Mehmet Kraja ka lindur më 1952, në Krajë, afër Liqenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartin në Universitetin e Prishtinës, degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në vitin 1975. Në vitet 1974-'76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve "Bota e re". Më pas punoi gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja". Në fillim të viteve '90 të shekullit XX u përfshi në zhvillimet politike të asaj kohe dhe ishte një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë viteve 1992-'99 jetoi dhe punoi në Tiranë, së pari në Zyrën e Kosovës dhe më pas redaktor në gazetën "Rilindja", botim i Tiranës. Pas luftës së vitit 1999 disa muaj ishte redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri", ndërsa nga viti 2000 redaktor i shtojcës për kulturë në gazetën "Koha ditore", si bashkëpunëtor i jashtëm. Në periudhën 2002-2018 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2005 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ka botuar trembëdhjetë romane ("Udhëzime për kapërcimin e detit", "Sëmundja e ëndrrave", "Im atë donte Adolfin", "Selvitë e Tivarit", "Hotel Arbëria", "E zeza dhe e kuqja", "Prishtina" etj.), katër përmbledhje me tregime ("Vdekja pa emër", "Portat e qiellit" etj.), pastaj tetë drama ("Princi i hijeve", "Hëna prej letre", "Grafitet" etj.), si dhe shumë shkrime publicistike me angazhime kulturore dhe politike. Ka fituar një sërë çmimesh letrare në Kosovë dhe në Shqipëri.

5.99€

ISBN 978-9951-780-56-8



Mehmet Kraja • HËNA PREJ LETRE

Mehmet Kraja



# HËNA PREJ LETRE

(Drama, trilogji)







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

